

17650

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 17650 Regj.

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, me daten 02.09.1997, une Gjyqtaria Enxheta Cefo . e Gjykates se Rrethit te Tiranes, mbasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit Skender Zela dhe Besnik Shtylla, per regjistrimin si person juridik,

K O N S T A T O V A

Shtetasit Skender Zela dhe Besnik Shtylla, kane paraqitur kerkesen per t'u regjistruar si person juridik ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te formuar prej tyre me emrin "EURO-AL" SHPK

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EURO-AL" SHPK disponon kapitalin e nevojshem fillestar per regjistrimin e saj , i cili perbehet nga shuma 100.000 te depozituara ne BKT. Ajo ka miratuar statutin dhe kontrate e krijimit te saj, te cilat jane ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11 1992 "Per shoqerite tregtare".

Ortake te shoqerise jane z. Skender Zela dhe Besnik Shtylla. Administrator i shoqerise eshte zoti Skender Zela.

Qendra e shoqerise ndodhet ne Tirane, ndersa selia e saj ne rrugen "Bulevardi Bajram Curri" pall.1 Maj Nr.3.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar,mbi 10 vjet.

Objekti i veprimtarise private te shoqerise do te jete: Importim. eksportim, tregtim me shumce e pakice te artikujve industrial te perdorimit te gjere, te konsumit apo artikuj ushqimore, Prodhim dhe tregtimin e artikujve te brumit si buke, biskota, makarona, veprimtari riparim sberbimi dhe tregtim te autogomave, vajrave industriale, karburanteve dhe

pjeseve te kembimit, veprimtari te transportit te mallrave, me cfardo mjeti transporti, per llogari te shoqerise apo te treteve

PEL KETO ARSYE

Ne Baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr.7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar"

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO-AL" SHPK

Ortak te shoqerise jane z. Skender Zela dhe Besnik Shtylla?

Administrator i shoqerise eshte zoti Skender Zela.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Gendra e saj eshte ne Tirane, ndersa selia ne rrugen "Bulev. Bajram Curri" pall.1 Maj Nr.3. Kohезgјatја e shoqerise eshte e pakufizuar mbi 10 vjet.

Objekti i veprimterise private te shoqerise do te jete:

Importimin, eksportimin, tregtimin me shumice e pakice te artikujve industrial te perdorimit te gjere, te konsumit apo artikujve ushqimore, prodhimin dhe tregtimin e artikujve te brumit si buke, biskota, mekarona, etj. veprimtari riparim-sherbimi dhe tregtim te automave, vejrave industriale, karburanteve dhe pjeseve te kembimit, veprimtari te transportit te mallrave, me cfardo mjeti transporti, per llogari te shoqerise apo te treteve.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

G J Y Q T A R E

Anila Capo



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
Nr. 17650/1 Vendimit

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

N<sub>e</sub> Tiranë sot në datë 23 04.2002 une gjyqtare  
e gjykates se shkalles se pare T<sub>1</sub>rane M. Deda  
mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi  
Skender Zela për depozitimin pranë rregjistrimit tregëtar  
te Gjykates te vendimit te asamblese se ortakëve te  
shoqërisë tregëtare " EURO - AL " shpk dhe

K O N S T A T O V A

S<sub>e</sub> me vendimin nr. 17650 datë 02.09.1997 është  
rregjistruar si person juridik shoqëria tregëtare  
" EURO - AL " shpk me dy ortakë s. Skender Zela dhe  
Besnik Shtylla.

Me vendimin e asamblese se ortakëve te kesaj  
shoqëri me nr. 1 datë 22.04.2002 është vendpsur largimi  
nga kjo shoqëri e ortakut Besnik Shtylla duke ju shitur  
kuota e kapitalit fillestar në masën 10 % ortakës që  
futet e re në këtë shoqëri s. Irma Kapllani, duke u bërë  
shoqëria me ortakë s. Skender Zela dhe Irma Kapllani.

Kërkesa është e drejte dhe si e tille duhet  
pranuar.

PER KETO ARSYE

N<sub>e</sub> bazë te ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 dhe te  
ligjit nr. 7667 datë 28.1.1993

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.

Depozitimin pranë rregjistrimit tregëtar te Gjykates  
te vendimit te asamblese se ortakëve te shoqërisë  
tregëtare " EURO - AL " shpk nr. 1 datë 22.04.2002, si dhe  
depozitimin e kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit.

Urdhërohet zyra e rregjistrimit tregëtar te beje  
ndryshimet perkatëse në kolumnën 4 germa \_\_\_\_\_.

GJYQTARE

*Mariang Deda*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE

Nr. 4650/2

**V E N D I M i Gjyqtarit te vetem.**  
PER DEPOZITIM TE AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane sot, me date 13.10.2007, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Ali Rupa mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi Z. Skender Zela, me cilesine e administratorit te shoqerise tregetare "EURO-AL" Sh.p.k., per depozitim te akteve te personit juridik

K O N S T A T O V A

Kerkuesi, me cilesine e administratorit te shoqerise tregetare "EURO-AL" Sh.p.k., e regjistruar si person juridik me **Vendim Nr. 17650 dt.02.09.1997** te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane (i ndryshuar), ka paraqitur prane kesaj gjykate, kerkese per depozitim ne rregjistrin tregetar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise date 03.07.2007, me te cilin Asambleja e Ortakeve, me unanimitet ka vendosur: Te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise ne Nenin 2 te Stutit te shoqerise, per te kryer veprimtari ne:

"Ndertimin, instalimin dhe shfrytezimin e centraleve elektrike, prodhimin, trasmetimin, shperndarjen, furnizimin e tregetimin, importimin e eksportimin e energjise elektrike", veprimtari e cila do te filloje te ushtrohet pasi shoqeria te paiset me licence. Gjykata cmon se kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar

PER KETO ARSYE

Bazuar ne Ligjin Nr.7667 dt.28/01/1993 "Per rregjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare", ne Ligjin Nr.7638 dt.19/11/1992 "Per shoqerite tregetare" dhe ne Ligjin 7632 date 04.11.1992

## VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimn ne regjistrin tregetar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise date 03.07.2007 , me te cilin me unanimitet eshte vendosur :

Te shtohet objektin e veprimtarise se shoqerise ne Nenin 2 te Statutit te saj,per te kryer veprimtari ne :

“Ndertimin, instalimin dhe shfrytezimin e centraleve elektrike, prodhimin, trasmetimin, shperndarjen, furnizimin e tregetimin, importimin e eksportimin e energjise elektrike ”, veprimtari qe do filloje te ushtrohet pasi shoqeria te paiset me licence nga organi kopetent.

Urdherimin e Zyres se Rregjistrit Tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen 2 germa “c” te rregjistrit.

**GJYQTARE**

*Marion Stefan Deso,*  
*Furqedy*

Ueslun uep:shun

17650

- Quantitativ "Euro-Pl. S.P.C"
- Teop-tapir 100.000 lelu
- Teolupzetje suber'ovjet
- Nu objekt, Modlunur Cunenurou, Culu d.
- Nu ortow Suruder Felo elle Besuie Slitulle, nu odun'urictor Shoudu Felo.
- Nu seli Kulevudi B. Cunen P'Noy.uz.  
Cunen

Statuti 7 fletu

Oldt Ale melidun. 3 fletu

Olote e Aurudelenunt 31.08.92  
 Olote e Uep'uridun 02.09.92.

Cyrtore

Cy

# KONTRATE E FORMIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EURO-AL" SH.P.K.

Sot ne daten ..... gusht 1997 ndermjet:

1. Skender Zela, i biri i Kadriut, I ditellindjes 13.08.1953, banues ne Tirane, rr. Islam Alla, 53
2. Besnik Shtylla, i biri i Beharit, I ditelindjes 14.10.1952, banues ne Tirana, Rr. Brigada 8, nr, 6

arrihet marveshja per formimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO-AL" sh. p.k. e cila do te regullohet ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe normave qe vijojne.

## Neni 1

Ortaket do te kryejne veprimtari tregtare private ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "EURO-AL" sh.p.k. me seli qendrore ne Bulevardin "Bajram Curri" Pall. 1 Maji, nr.3 ne Tirane.

Kohe zgjatja e shoqerise eshte fiksuar mbi 10 vjet, dhe mund te shtyhet ose te zgjdhjet para kohe me vendim te mbledhjes se ortakeve.

Ortake te kesaj shoqerie dhe pronare jane Z. Skender Zela dhe Z. Besnik Shtylla.

Ne baze te kontrates ne fjale veprimtaria e shoqerise "EURO-AL" sh.p.k. dhe drejtimi i saj do te behet konform me statutin e shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## Neni 2

Shoqeria e ka seline ne Republiken e Shqiperise, Bulevardi "Bajram Curri" Pall. 1 Maji, nr.3, Tirane.

## Neni 3

Shoqeria ka per objekt:

- importimin, eksportimin, tregtimin me shumice dhe me pakice te arikujve industriale te perdorimit te gjere, te konsumit apo artikujve ushqimore;
- prodhimin dhe tregtimin e artikujve te brumit si buke, biskota, makarona etj.
- veprimtari riparim-sherbimi dhe tregtim te autogomave, vajrave industriale, karburanteve dhe pjeseve te kembimit;



- veprimtari te transportimit te mallrave, me çfardo mjete transporti, per llogari te shoqerise apo te te treteve;

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe ne shtete te tjera.

Shoqeria mund te krijojte filiale apo perfqesi ne krahinat e tjera te vendit ose ne vende te tjera.

#### Neni 4

Kapitali I shoqerise eshte 100.000 leke, I ndare ne 100 kuota njesi me nga 1000 leke secila. Çdo kuote njesi prej 1000 leke I jep te drejten e nje vote.

Kapitali themeltar nenshkruset teresisht dhe po ashtu eshte shlyer nga ortakët, sipas kuotave pjesemarrrese si vijon:

- Skender Zela me 90 perqind te kuotave, e barabarte me 90.000 leke.
- Besnik Shtylla me 10 perqind e kuotave, e barabarte me 10.000 leke.

#### Neni 5

Te ardhurat e realizuara nga shoqeria do te ndahen pjeserisht ose totalisht ndermjet ortakëve sipas kuotes se tyre te pjesemarrjes, pasi te jete lene menjane nje shume te pakten sa 1/20 e tij, e cila destinohet per formimin e fondit rezerve.

#### Neni 6

Ne kohen e perfundimit te afatit ose te prishjes se shoqerise, kur nuk ka zgjatje afati, kapitali i shoqerise mbasi te hiqen debitet e saj, do te ndahet proporcionalisht ndermjet ortakëve sipas kuotave te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar.

#### Neni 7

Aktiviteti ekonomik i shoqerise dhe investimet e personave te huaj ne te jane te mbrojtura nga shteti Shqiptar, qe u siguron atyre kushte te barabarta me ato te shtetasve shqiptare.

#### Neni 8

Organet e shoqerise jane:

Asambleja e Ortakëve





Administratoret dhe

Eksperti Kontabel i autorizuar.

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte drejtues i shoqerise. Ortaket mund te perfaqsohen ne mbledhje vetem sipas ligjit, nga ortake te tjere ose nga persona te besimit me prokure te rregullt te firmosur.

Neni 9

Perfaqsimi i shoqerise tek te tretet dhe ne gjykim i takon administratoreve.

Administrator i shoqerise emerohet Skender Zela.

Neni 10

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin e rezervuar te dokumentacionit, te informacioneve dhe eksperiences se shkembyer ose te realizimeve te shoqerise dhe te perdorin te gjitha mjetet e nevojshme per te mos perhapur edhe pjeserisht keto informacione.

Neni 11

Heqja dore nga kuota e vet ose transferimi mund te behet nga ortaket sic eshte parashikuar ne statut dhe legjislacioni ne fuqi.

Neni 12

Çdo mosmarreveshje, qe mund te linde midis shoqerise dhe ortakeve do te zgjidhet sipas legjislacionit shqiptar. Organi kompetent per zgjidhjen e mosmarreveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

Neni 13

Persa nuk parashikohet ne kete kontrate, do te aplikohen nenet e statutit te shoqerise dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Ortaket, pasi lexuam me vemendje kontraten e mesiperme dhe e gjeten proform vullnetit tet tyre, e firmosin ate.

**ORTAKET**

**SKENDER ZELA**

**BESNIK SHTYLLA**

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"EURO-AL" SH.P.K.**

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHEZGJATJA.

Neni 1

Shoqeria "EURO-AL" sh.p.k. fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve krijuese, si ky statut dhe kontrata, qe i bashkengjitet.

Neni 2

Shoqeria ka per objekt te saj :

- importimin, eksportimin, tregtimin me shumice dhe me pakice te artikujve industriale te perdorimit te gjere, te konsumit apo artikujve ushqimore;
- prodhimin dhe tregtimin e artikujve te brumit si buke, biskota, makarona etj.
- veprimtari riparim-sherbimi dhe tregtim te autogomave, vajrave industriale, karburanteve dhe pjeseve te kembimit,
- veprimtari te transportimit te mallrave, me çfardo mjete transporti, per llogari te shoqerise apo te te treteve;

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne Bulevardin "Bajram Curri" Pall. 1 Maji, nr.3, ne Tirane.

Ajo do te zhvilloje veprimtari ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

Shoqeria me vendim te saj mund te krijojë dege ose perfaqsi dhe ne rrethe te tjera te Shqiperise si edhe jashte saj.

Administrator I kesaj shoqerie eshte Z. Skender Zela.



#### Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë është fiksuar mbi 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Ajo mund të shpërndahet përpara kësaj afati me vendim unanim të ortakëve, ose kur verifikohen rrethana të tilla që shpërndarja e saj urdherohet në mënyrë të shprehur nga ligji.

### KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

#### Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke, duke u bazuar në kuotat si më poshtë:

- Skender Zela me 90 përqind të kuotave, e barabartë me 90.000 leke.
- Besnik Shtylla 10 përqind të kuotave, e barabartë me 10.000 leke.

Pjesët respektive të kapitalit themeltar nënshkruhen teresisht dhe po ashtu shlyhen nga ortakët.

Në asnjë rast pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime.

#### Neni 6

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 kuota, vlera e të cilave është nga 1000 leke secila.

Kuotat janë nominative dhe lirisht të transferueshme midis ortakëve.

Transferimi i kuotave bëhet vetëm me akt noterial.

Cdo transferim i kuotave tek të tretët i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga ortakët e tjerë.

#### Neni 7

Ndryshimet në kapitalin themeltar si për shtimin apo zvogelimin e tij bëhen me vendim unanim të asambleës së ortakëve sipas normave të kësaj statuti.



#### Neni 8

Bashkimi i pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise nuk sjell shperberjen e shoqerise.

#### Neni 9

Per tjetersimin e kuotave te treteve Ortaku duhet te njoftoje shkreserisht shoqerine, e cila brenda tre muajve nga dita e marrjes dijeni duhet te jape vendimin per lejimin e transferimit, i cili kerkon miratimin e ortakut tjetër. Kur nje vendim te tille shoqeria nuk e komunikon brenda tre muajve, miratimi per transferim konsiderohet i dhene.

Ne rast se lind nevoja per vleresimin e kuotave, ortakët caktojne ekspert. Ne rast se nje gje e tille nuk arrihet prej tyre, caktimi i ekspertit behet nga Gjykata e Rrethit Tirane.

### ORGANET E SHOQERISE. ASAMBLEJA E ORTAKEVE.

#### Neni 10

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte drejtues i shoqerise. Vendimet e asamblese te marra ne perputhje me ligjin dhe normat e ketij statuti si edhe te aktit themelues te shoqerise jane te detyrueshme per te gjithë ortakët.

#### Neni 11

Asambleja e ortakeve thirret nga njeri prej ortakeve, nga administratori ose eksperti kontabel dhe mbahet rregullisht ne qendren e shoqerise. Thirjet behen me shkrim dhe ju komunikohen Ortakeve ne vendbanimet e tyre te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Ne thirje shenohet vendi, koha dhe rendi i dites se mbledhjes.

#### Neni 12

Cdo ortak mund te perfaqsohet ne mbledhjen e Asamblese nga nje person i trete me prokure mjaft qe ata te mos jene administratore te shoqerise. Mandatet



e perfaqsesve verifikohen nga drejtuesi i mbledhjes. Asambleja drejtohet nga administratori.

#### Neni 13

Cdo ortak ka te drejten e nje vote per cdo kuote ne zoterim.

Vendimet e asamblese per cdo problem merren me vendimin unanim te ortakeve.

### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

#### Neni 14

Shoqeria administrohet nga nje administrator.

Administratoret emerohen per nje periudhe te pakufizuar kohe, dhe mund te revokohen ne cdo kohe.

Emerimi i administratorit behet me vendim unanim te dy ortakeve.


#### Neni 15

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise, qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj me perjashtim te atyre kompetencave qe me ligj jane te Asamblese se Ortakeve.

Administratorit i takon firma e shoqerise dhe perfaqsimi i saj perpara te treteve.

Shoqeria nuk merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit dhe pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin se akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise, ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena.

Ai pergjigjet perpara shoqerise per veprimet e kryera ne kundërshtim me ligjin, statutin apo per faje te kryera gjate ushtrimit te detyres.



## KONTROLLI I ORTAKEVE

### Neni 16

Cdo Ortak ka te drejte dy here ne vit te paraqese kerkese me shkrim administratorit per te kerkuar sqarime lidhur me vazhdimin e veprimtarise se shoqerise.

## MARRREDHENIET E PUNES NE SHOQERI

### Neni 17

Marreveshja e punes ne shoqeri rregullohet ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut.

### Neni 18

Punesimi ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates individuale per secilin te punesuar.

### Neni 19

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve te saj ne organet perkatese, duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara, sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### Neni 20

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

## BILANCI DHE FITIMET

### Neni 21

Pas perballimit te detyrimeve dhe taksave e tatimeve shpenzimeve te ndryshme, Ortakeve u mbetet ne dispozicion fitimi neto.

### Neni 22

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fondet e tjera financiare te veçanta, per zhvillimin e saj, per nxitje ekonomike, te valutes etj.



#### Neni 23

Fitimi neto mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit themeltar, per shtimin e tij ne natyre ose ndahet sipas perqindjes se kontributit te kapitalit themeltar.

#### Neni 24

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me dt. 31.12 te çdo viti. Viti i pare financiar perfundon me 31.12.1997.

Bilanci vjetor i nenshtrohet miratimit te asamblese se ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Bilanci vjetor duhat te paraqitet brenda 31.03 te vitit pasardhes.

### ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE. LIKUIDIMI I SHOQERISE.

#### Neni 25

Organi kompetent shteteror per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te mundshme, te cilat nuk mund te zgjidhen brenda shoqerise, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane, sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar.

#### Neni 26

Ne rast se shoqeria shperndahet ne cdo kohe dhe per çfardo shkak, asambleja percakton menytrat e likuidimit dhe emeror nje ose me shume likuidues mandati i te cileve jo me shume se tre vjet.

#### Neni 27

Ne kohen e mandatit te tij likuiduesi perfaqson shoqerine. Ai vendos te shperndaje fondet, por duke mbajtur parasysh te drejtat e kreditoreve.



Neni 28

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve nga asambleja e Ortakeve si edhe ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare"

SKENDER ZELA

BESNIK SHTYLLA

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE  
TIRANE

Nr. 331P Rep.  
Nr. 488 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, me date 31.08.1997, para meje noterit u paraqiten z. Skender Zela dhe Besnik Shtylla, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin u garantova nga pasaporta te cilet deklaruan se kane redaktuar jashte kesaj zyre statutin e shoqerise "EURO-AL" SHPK dhe ne prezence e nenshkruajne ate.

NOTERI  
*N. Kelle Ciuni*  
REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PULLE TAKSE  
20 LEKE  
R.SHQIPERISE



REGJISTRUAR  
DT: 05 - 09 - 97  
CAKTUAR GJYOTARIT

*Handwritten signature*

KERKESË



Kerkuesit :

1. Skender Zela, i biri i Kadriut, I ditellindjes 13.08.1953, banues ne Tirane, rr. Islam Alla, 53

2. Besnik Shtylla, i biri i Beharit, I ditelindjes 14.10.1952, banues ne Tirana, Rr. Brigada 8, nr, 6

Objekti i kerkeses: Rregjistrimi si person juridik i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO-AL" sh.p.k.

Baza ligjore: Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji nr. 7667 date 28.1.1993 "Per rregjistrimin ne regjistrin tregtar".

*102226  
00134*

**GJYKATES SE RRETHIT TIRANE**

*60 regjistruar*

Ne ortaket e shoqerise Skender Zela dhe Besnik Shtylla, kerkojme regjistrimin e shoqerise "EURO-AL" sh.p.k. me seli ne Bulevardin "Bajram Curri" Pall. 1 Maji, nr.3, ne regjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane, si person juridik.

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke.

Afati i kesaj shoqerie do te jete mbi dhjete vjet.

Objekti i saj do te jete si vijon :

- importimin, eksportimin, tregtimin me shumice dhe me pakice te artikujve industriale te perdorimit te gjere, te konsumit apo artikujve ushqimore;
- prodhimin dhe tregtimin e artikujve te brumit si buke, biskota, makarona etj.
- veprimtari riparim-sherbimi dhe tregtim te autogomave, vajrave industriale, karburanteve dhe pjeseve te kembimit;
- veprimtari te transportimit te mallrave, me çfardo mjeti trasnporti, per llogari te shoqerise apo te te treteve;

Kemi plotesuar te gjithë dokumentacionin e nevojshem si statutin, kontraten e krijimit te shoqerise, pagesen per kapitalin themeltar, si dhe kemi bere noterizimin e dokumenteve sipas kerkesave te ligjeve te mesiperm.

Persa me sipër KERKOJME:

Qe nga ana juaj te merret ne shqyrtim kjo kerkese dhe ne perfundim te vendoset regjistrimi sipas objektit te saj



**ORTAKET**

**SKENDER ZELA**

**BESNIK SHTYLLA**

Nr. 3316 Rep.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DNOMA E NOTERIVE  
TIRANE

VERTETIM

Ne Tirane, ne date 31.08.1997, para meje noterit u paraqiten z. Skender Zela dhe Besnik Shtylla, banoras ne Tirane, ma-dhor me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin u garantova nga pasaportat te cilet deklaruan se kane redaktuar jashte kesaj zyre kerkesen per ne Gjykatën e Tiranës per krijimin e SH.P.K dhe ne prezence nenshkruajme dhe une e vertetoj.

NOTERI

*N. Shylla*

17650/1

KERKUESE

3 M Dodi  
23 04 1997  
*[Signature]*

Skender Zela Administrator i shoqerise tregëtare  
"EURO - AL" shpk banues ne [illegible]



OBJEKTI Depozitimin pranë regjistrorit tregëtar te Gjykatës te vendimit te asamblese se ortakëve te shoqerise tregëtare "EURO - AL" shpk ne baze te ligjit nr. 7378 date 19.11.1992 dhe te ligjit nr. 7567 date 31.1.1993

*Be*  
*depozitimi*  
*icel uase*  
*reuzioni*

GJYKATESI SE SHQIPERISE PARE

TIRANE

Me vendimin nr. 17650 data 02.09.1997, eshte reregjistruar si person juridik shoqeria tregëtare "EURO - AL" shpk me dy ortakë z. Skender Zela dhe Besnik Shtylla.

Me vendimin e asamblese se ortakëve te kësaj shoqerie eshte vendpsur largimi nga kjo shoqerie e ortakut Besnik Shtylla dhe shitja e kuotes se kapitalit fillestar te tij ortakës ne futet ne ne kete shoqeri z. Irma Kapllani.

Kerkojme depozitimin e ketij vendimi pranë regjistrorit tregëtar.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA E TIRANES

KERKUESI  
SKENDER ZELA

Nr. 2/197 Rep

VERBETIM 21.04.2002

Vertetohet se kerkese e paraqitur nga kerkuesi per depozitimin e vendimit te asamblese se ortakëve u nenshkrua ne prezencen time nga kerkuesi Skender Zela per indetitetin e te cilit u shpreh nga [illegible] indetifikues dhe une noter e vertetof sipas ligjit nr. 7378 date 19.11.1992 dhe te ligjit nr. 7567 date 31.1.1993



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA E TIRANES  
Nr. 2119 Rep



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane sot me dx date 22.04.2002 para meje  
noterit u paraqiten palet per hartimin e konteates se  
shitjes se kuotave si me poshte :

SHITESI Besnik Shtylla i biri i Beharit i dtl.  
14.10.1950 banues ne Tirane indetifikuar me pasaporte me  
nr. 0594489, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

BLERESI Irma Kapllani e bija e Qaniut e dtl.  
4 dhjetor 1957 banues ne Tirane bulevardi B. Curri pallati 1  
maj nr. 3., madhore me zotesi te plote juridike per te  
vepruar.

Shitesi Besnik Shtylla eshte ortak i shoqerise  
tregetare " EURO - AL " shpk e rregjistruar si person juridik  
me vendimin e gjykates me nr. 17650 date 02.09.1997, me nje  
kapital fillestar 10 %, baraz kjo me 10.000 leke.

Me vendimin e asamblese se ortakeve te kesaj  
shoqerie eshte vendpsur te largohet nga kjo shoqeri  
z. Besnik Shtylla duke ju shitur kuota e kapitalit ne  
masen 10 % baraz kjo me 10.000 leke ortakes se re qe futet  
ne kete shoqeri z. Irma Kapllani ne masen 10 % baraz me ~~1000~~  
10.000 leke e cila eshte dakort qe te bleje kete kuote.  
Pasi u be dhe shlyerja e detyrimit perkates, ortaku qe largohet  
zhvishet nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i perkasin  
shoqerise, dhe i kalojne ortakes qe fute Irma Kapllani.

SHITESI  
BESNIK SHTYLLA

BLERESIA

IRMA KAPLLANI

Noteri  
NEZIR MURATI



V E N D I M

Nr. 1 date 22.04.2002

ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGETSRE

" EURO - AL " shpk



Ne asambleja e ortakeve te shoqerise tregetare " EURO - AL " shpk e perbere nga ortaket z. Skender Zela dhe Besnik Shtylla , unanimisht dhe pa verejtje kemi vendpsur :

Largimin nga kjo shoqeri te ortakut Besnik Shtylla duke ju shitur kuota e kapitalit ne masen 10 % ortakes qe futet e re ne kete shoqeru z. Irma Kapllani, duke u zhveshur ortaku qe largohet nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i perkasin shoqerise , dhe duke i kaluar dhe ortakes Irma Kapllani. Mbledhja u mbyll me kete rend dite.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE  
TREGETARE " EURO - AL " shpk

SKENDER ZELA

BESNIK SHTYLLA

REPUBLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA E TIRANES

Nr. 2118 Rep

Tirane , me 22.04.2002

VERTETIM

Vertetohet se vendimi i asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare " EURO - AL " shpk u nenshkrua ne prezencen time nga ortaket e mesiperm per indetitetin e te cileve u sigurova nga dokumenti indetifikues dhe une noter e vertetoj sipas ligjit.



NOTERI  
NEZIR MURATI



*z. M. Bedli  
dt. 04.07.2007  
04 July  
06.2007*

# K E R K E S E

KERKUES: Shoqeria "EURO-AL" Sh.p.k. e perfaqesuar nga administratori I saj z. SKENDER ZELA, i biri i Kadriut, i datelindjes 1953, lindur dhe banues ne Tirane

OBJEKTI: Depozitimin ne rregjisterin tregetar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve date 04.07.2007 per "shtese ne objektin e veprimtarise se shoqerise".

BAZA

LIGJORE : Ligji Nr.7632 date 4.11.1992  
Ligji Nr.7667 dt.28/01/1993  
Ligji Nr.7638 dt.19/11/1992

*(2) Kopje depozitimit  
vendimit i Asamblese se  
ortakeve  
Nr - dt 03.07.07*

PERPARA : GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

*Nr 458 Rg / 506 uel*

TIRANE

*dt. 04.07.07*

Znj. GJYQTARE !

*dt. 13.07.07*

Shoqeria tregetare "EURO-AL" Sh.p.k. eshte regjistruar si person juridik ne baze te **Vendimit Nr.17650 dt.02.09.1997** te Gjykates se Rrethit Tirane.

Asambleja e Ortakeve bazuar ne Statutin e shoqerise me vendim date 04.07.2007 ka

vendosur : Te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise duke bere shtese ne Nenin 2 te

Statutit ne kete menyre :

*M. Bedli  
M. Sulejmani  
D. Bedli*

**"Ndertimin, instalimin dhe shfrytezimin e centraleve elektrike, prodhimin, trasmetimin, shperndarjen, furnizimin e tregetimin, importimin e eksportimin e energjise elektrike."**

Bashkalidhur kerkeses ju paraqes kopjen e Vendimit qe kerkohet te depozitohet.

KERKUES

*Skender Zela*  
Skender Zela

**V E N D I M**  
**I**  
**ASAMBLESE SE ORTAKEVE**  
**TE SHOQERISE TREGETARE**  
**“ EURO-AL “ Sh.p.k.**

Sot, me date 03.07.2007 , ne seline e shoqerise ne Tirane ne bulevardin “Bajram Curri” pall.”1 Maji” nr.3, u mbajt mbledhja e Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare “ EURO-AL” Sh.p.k., e cila mori ne shyrtim dhe vendosi per sa vijon :

Morren pjese :

1. Z.Skender Zela zoterues i 90 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise dhe
2. Znj.Irma Kapllani e cila zoteron 10 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.

Rendi i dites :

- Shtese ne objektin e veprimtarise se shoqerise.

Shoqeria tregtare “EURO-AL ” Sh.p.k. eshte person juridik i regjistruar ne regjistrin tregetar te gjykates ne baze te **Vendimit Nr.17650 dt.02.09.1997** te Gjykates se Rrethit Tirane.

Asambleja e Ortakeve bazuar ne Statutin e shoqerise , duke konsideruar zgjerimin e veprimtarise se shoqerise ne aplikimin per marrjen me koncension te burimeve hidrike dhe prodhimin e energjise elektrike, vlereson se eshte e nevojshme shtimi i objektit te veprimtarise se shoqerise ne kete drejtim.

Nisur nga sa me larte dhe bazuar ne Ligjit 7638 dt.19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, Asambleja e Ortakeve , me unanimitet

**vendosi :**

Te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise ne kete menyre :

“Ndertimin, instalimin dhe shfrytezimin e centraleve elektrike, prodhimin, trasmetimin, shperndarjen, furnizimin e tregetimin, importimin e eksportimin e energjise elektrike .”

Ngarkohet administratori i shoqerise per depozitimin ne regjistrin tregetar te gjykates te kesaj shtese ne nenin 2 te Statutit te shoqerise.